

## **RREGULLORE E EDUKIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

(Për edukimin profesional të kandidatëve dhe zhvillimin profesional të vijueshëm të ekspertëve kontabël të regjistruar)

Në zbatim të Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertëve Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) të Statutit të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Regjistruar dhe të kërkesave që burojnë nga detyrimet e anëtarësisë të IEKAs në IFAC, bazuar edhe në eksperiencën e deritanishme dhe në përvojën më të mirë ndërkombëtare, Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të IEKA-s, aprovon këtë rregullore të edukimit dhe kualifikimit profesional.

### **Kapitulli 1**

#### **Objekti**

#### **Seksioni 1**

#### **Objekti dhe fusha e veprimit**

Kjo rregullore përcakton:

- Rregullat e udhëzimet për pranimin, monitorimin dhe edukimin e kandidatëve për ekspertë kontabël të autorizuar, ku përfshihen
  - procedurat e pranimit në stazhin profesional,
  - shpallja e programeve të edukimit dhe
  - vlerësimi i edukimit paraprak të kandidatëve,
  - zhvillimi dhe monitorimi i stazhit dhe
  - testimet paraprake për njohuritë e marra gjatë stazhit.
- Rregullat dhe udhëzimet që zbatohen për zhvillimin profesional të vijueshëm (kualifikimin e vazhdueshëm) të ekspertëve kontabël të regjistruar ku përfshihen:
  - shpallja e programeve të kualifikimit të vijueshëm,
  - procedurat e organizimit dhe monitorimit të kualifikimit të vijueshëm,
  - procedurat e vlerësimit të kualifikimeve të realizuara nga Instituti ose nga entitete të njohura nga jashtë Institutit si dhe
  - procedurat e testimit të njohurive të marra.

## Seksioni 2

### Komiteti i Edukimit të Kandidatëve (KEK) për EKR

#### 1. Krijimi dhe funksionimi

Për të siguruar edukimin profesional të kandidatëve dhe kualifikimin e vijueshëm të anëtarëve të Institutit, ngrihet dhe funksionon në formën e një komiteti të përhershëm, Komiteti i edukimit të kandidatëve për EKR.

Komiteti i edukimit të kandidatëve për EKR përbëhet nga 3 vetë. **Kryetar** i Komitetit caktohet njëri nga anëtarët e Këshillit drejtues, **një anëtar** caktohet nga anëtarësia e ekspertëve kontabël të cilët e ushtrojnë profesionin, dhe një **anëtar tjetër** caktohet nga jashtë anëtarësisë së Institutit, midis individëve të spikatur nga bota akademike apo profesionale e rregullatore.

Mandati i Kryetarit të Komitetit është i lidhur me mandatin e tij në Këshillin Drejtues. Anëtarët e Komitetit zgjidhen me një mandat 3 vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Në marrëdhëniet me Këshillin Drejtues, me asamblenë apo për çështje të tjera specifike, Komiteti i edukimit të kandidatëve për EKR përfaqësohet nga Kryetari i tij.

Anëtarët e Komitetit të Edukimit të kandidatëve për EKR caktohen nga Këshilli Drejtues.

Drejtori Ekzekutiv i siguron Komitetit të edukimit të kandidatëve për EKR, përmes personelit ekzekutiv të Institutit, asistencën e nevojshme me punë sekretariale, organizative dhe dokumentare.

#### 2. Të drejtat dhe detyrat

Komiteti i edukimit **të kandidatëve për EKR** ka këto të drejta dhe detyra:

a) I propozon për miratim Këshillit Drejtues:

- projekt programet e edukimit, të cilat përmbajnë trungun e disiplinave teorike bazë, që kandidatët për ekspertë kontabël duhet të kenë studiuar gjatë edukimit universitar.
- programet e edukimit gjatë stazhit. Këto programe përgatiten në varësi të nevojave për edukimin profesional të kandidatëve dhe të disiplinave të percaktuara në nenin 18 të ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009.

b) Shqyrton kërkesat e kandidatëve për të hyrë në stazh, miraton marrëveshjet e stazhit dhe i propozon për miratim Këshillit Drejtues të Institutit listën emërore të kandidatëve për të cilët është marrë vendimi për pranimin në stazh.

c) Organizon:

- kualifikimet profesionale të nevojshme,
- testimet e kandidatëve që aplikojnë për të hyrë në stazh,<sup>i\*</sup>

- testimet që shërbejnë për të vlerësuar ecurinë e formimit profesional të kandidatëve gjatë stazhit.
- d) Mbikqyr kryerjen e stazhit nga kandidatët, ndjek udhëheqjen e kandidatëve nga ana e drejtuesve të stazhit, dhe jep udhëzimet e nevojshme kur gjykon se udhëheqja nuk është e mjaftueshme ose është e papërshtatshme.
- e) I propozon Këshillit Drejtues zgjatjen e kohës së stazhit për ata kandidatë, për të cilët formimi vlerësohet i pamjaftueshëm ose edhe për pezullimin apo përjashtimin nga stazhi në rastet e shkeljeve të përsëritura apo të rënda të rregullave.
- f) Asiston për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve midis drejtuesit të stazhit dhe kandidatit.
- g) Bën vlerësimet për ecurinë e përgatitjes së kandidatëve dhe lëshon certifikatën përkatëse në përfundim të stazhit.
- h) Jep mendime për Këshillin drejtues për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me edukimin profesional të kandidatëve.

### **3. Procedurat e punës**

Komiteti i edukimit të kandidatëve mbledhet me thirrjen e kryetarit sa herë që është e nevojshme.

Mbledhja njoftohet të paktën 3 ditë para datës së zhvillimit dhe njoftimi përmban rendin e ditës.

Komiteti mund të shqyrtojë një çështje dhe të marrë një vendim, kur në mbledhje sigurohet prania e shumicës së anëtarëve të tij.

Kur mbledhja pengohet pa arsye nga Kryetari, Këshilli drejtues mund të caktojë njërin nga anëtarët e tjerë të tij për zhblokimin e situatës dhe vazhdimin me drejtimin e mbledhjeve.

Kur një anëtar i komitetit të edukimit të kandidatëve nuk merr pjesë pa arsye në tre mbledhje rresht, këshilli drejtues ka të drejtën e zëvendësimit të tij.

Mbledhjet e Komitetit të edukimit të kandidatëve dokumentohen me proces verbal i cili firmoset nga kryetari dhe nga njëri anëtar i komitetit, i cili nuk është anëtar i Institutit, si dhe nga sekretari i caktuar nga drejtori ekzekutiv.

Vendimet e Komitetit merren me shumicën e votave të anëtarëve dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët. Vendimet depozitohen në selinë e Institutit dhe fotokopje të tyre u jepen të gjithë anëtarëve të komitetit, me kërkesën e këtyre të fundit.

#### 4. Raportimi

Komiteti i Edukimit të kandidatëve i raporton për veprimtarinë e tij me shkrim Këshillit Drejtues dy herë në vit, respektivisht për gjashtë mujorin brenda datës 30 korrik dhe për veprimtarinë vjetore brenda datës 20 Mars të vitit pasardhës\*. Në këtë raport ai mund të shprehet edhe për çështje të tjera të kësaj fushe dhe mund të bëjë propozime, të cilat ai i gjykon të nevojshme.

### Seksioni 3

#### Komiteti Kualifikimit të Vijueshëm të Anëtarëve (KKV)

##### 1. Krijimi dhe funksionimi

Për të siguruar kualifikimin e vijueshëm të anëtarëve të Institutit, ngrihet dhe funksionon në formën e një komiteti të përhershëm, Komiteti i kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve (KKV).

Komiteti i kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve përbëhet nga 3 vetë. **Kryetar** i Komitetit caktohet njëri nga anëtarët e Këshillit drejtues, dhe **dy anëtarë** caktohen nga anëtarësia e ekspertëve kontabël të cilët e ushtrojnë profesionin.

Mandati i Kryetarit të Komitetit është i lidhur me mandatin e tij në Këshillin Drejtues. Anëtarët e Komitetit zgjidhen me një mandat 3 vjecar me të drejtë rizgjedhje.

Në marrëdhëniet me Këshillin Drejtues, me asamblenë apo për çështje të tjera specifike, KKV përfaqësohet nga Kryetari i tij.

Anëtarët e KKV caktohen nga Këshilli Drejtues.

Drejtori Ekzekutiv i siguron KKV, përmes personelit ekzekutiv të Institutit, asistencën e nevojshme me punë sekretariale, organizative dhe dokumentare.

##### 2. Të drejtat dhe detyrat

Komiteti i kualifikimit të vijueshëm profesional ka këto të drejta dhe detyra:

- i) I propozon për miratim Këshillit Drejtues projekt programet afatshkurtëra (njëvjecare) dhe afatmesme (tre vjecare) si edhe projekt strategjitë për zhvillimin profesional të vijueshëm të ekspertëve kontabël të regjistruar.
- j) Në bashkëpunim me drejtorin ekzekutiv, dhe në pajtim me vendimet e Këshillit Drejtues, organizon procesin e zhvillimit të vijueshëm të anëtarëve të IEKAs, dhe komunikon me lektorët për zhvillimin e temave teorike e praktike të parashikuara në programin e kualifikimit të miratuar nga Këshilli Drejtues.

- k) I propozon për miratim Këshillit Drejtues mënyrën dhe kriteret e monitorimit dhe të vlerësimit të procesit të zhvillimit të vijueshëm të anëtarëve, si në rastet kur kualifikimet organizohen nga IEKA ashtu edhe në rastet kur kualifikimet organizohen nga entitetet jashtë institutit.
- l) Në bashkëpunim me drejtorin ekzekutiv dhe në pajtim me vendimet dhe politikën e këshillit drejtues, organizon procesin e testimit të anëtarëve për vlerësimin e njohurive të fituara gjatë zhvillimit të vijueshëm profesional.
- m) Vlerëson rezultatet dhe ecurinë e zhvillimit të vijueshëm profesional të anëtarëve dhe i propozon Këshillit Drejtues për masat që duhen ndërmarrë për përmirësimin e situatës, kur zhvillimi profesional i vijueshëm nuk ka qenë efektiv, si edhe për veprimet e mëtejshme që duhet të ndërmerren ndaj ekspertëve kontabël të regjistruar, që nuk kanë arritur të marrin provimet që lidhen me kualifikimin e vijueshëm, nuk kanë marrë pjesë në seminarët e kualifikimit të vijueshëm, apo kanë depozituar dokumente të pavërteta për kryerjen e kurseve të kualifikimit të vazhdueshëm, për rastet kur këto kurse zhvillohen nga entitetet e treta.
- n) Jep mendime për Këshillin drejtues për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kualifikimin dhe zhvillimin profesional të vijueshëm të anëtarëve.

### **3. Procedurat e punës**

Komiteti i kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve mblidhet me thirrjen e kryetarit sa herë që është e nevojshme.

Mbledhja njoftohet të paktën 3 ditë para datës së zhvillimit dhe njoftimi përmban rendin e ditës.

Komiteti mund të shqyrtojë një çështje dhe të marrë një vendim, kur në mbledhje sigurohet prania e shumicës së anëtarëve të tij.

Kur mbledhja pengohet pa arsye nga Kryetari, Këshilli Drejtues mund të caktojë njërin nga anëtarët e tjerë të tij për zhblokimin e situatës dhe vazhdimin me drejtimin e mbledhjeve.

Kur një anëtar i KKV-së nuk merr pjesë pa arsye në tre mbledhje rresht, këshilli drejtues ka të drejtën e zëvendësimit të tij.

Mbledhjet e KKV-së dokumentohen me proces verbal i cili firmoset nga kryetari dhe nga njëri anëtar i komitetit, si dhe nga sekretari i caktuar nga drejtori ekzekutiv.

Vendimet e Komitetit merren me shumicën e votave të anëtarëve dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët. Vendimet depozitohen në selinë e Institutit dhe fotokopje të tyre u jepen të gjithë anëtarëve të komitetit, me kërkesën e këtyre të fundit.

## 4. Raportimi

Komiteti i Kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve i raporton për veprimtarinë e tij me shkrim Këshillit Drejtues dy herë në vit, respektivisht për gjashtë mujorin brenda datës 30 korrik dhe për veprimtarinë vjetore brenda datës 20 Mars të vitit pasardhës\*. Në këtë raport ai mund të shprehet edhe për çështje të tjera të kësaj fushe dhe mund të bëjë propozime, të cilat ai i gjykon të nevojshme.

## Kapitulli 2

### Edukimi profesional i kandidatëve

#### 1. Të përgjithshme

Stazhi profesional ka për qëllim të përgatitë kandidatët për të hyrë në profesionin e ekspertit kontabël, dhe siguron për edukimin e tyre të mëtejshëm teorik e praktik dhe zhvillimin e aftësive, të zotësive profesionale dhe të vlerave e qëndrimeve etike.

Stazhi profesional presupozon përfshirjen e kandidatit në veprimtari profesionale që janë ose kanë lidhje të ngushtë me auditimin ligjor të pasqyrave finaciare, individuale ose të konsoliduara

#### 2. Kushte për pranimin\* e kandidatëve dhe kryerjen e stazhit

Përpara procesit të testimeve për EKR\*, kandidatët duhet të kryejnë një stazh profesional, i cili realizohet në kushtet e:

- një kontrate punësimi me kohë të plotë me afat 3-vjecar; dhe/ose
- një kontratë punësimi me kohë të pjeshme me afat 5-vjecar
- një kontratë shërbimi për personat që ushtrojnë profesionin e Kontabilistit të Miratuar\*

të lidhur midis kandidatit dhe ekspertit kontabël të rregjistruar, në të cilën përcaktohet orari, kohëzgjatja e punës së kandidatit pranë drejtuesit të stazhit dhe rregullohen çështje të tjera të marrëdhënieve të punësimit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Në rast se gjatë kryerjes së stazhit, ndryshojnë kushtet e marrëdhënies së punës midis stazhierit dhe udhëheqësit, Komiteti i Edukimit të kandidatëve (KEK) bën konvertimin e kontratës së stazhit vetëm në rastet kur kërkohet të bëhet ndryshimi nga kontratë me kohë të pjesëshme (5-vjecare) në kontratë punësimi me kohë të plotë (3-vjecare) dhe nga kontratë shërbimi në kontratë punësimi me kohë të plotë (3-vjecare). Ndryshimet e kontratave duhet të jenë pjesë e raportimit të Komitetit Edukimit në Këshillin Drejtues\*.

Stazhi profesional kryhet pranë dhe nën kujdesin e një drejtuesi i cili duhet të jetë ekspert kontabël i regjistruar prej të paktën tre vjetësh.

Një ekspert kontabël me përvojë mbi pesë vjet mund të drejtojë deri në tre kandidatë në të njëjtën kohë, ndërsa një ekspert me përvojë 3-5 vjet mund të drejtojë vetëm një kandidat.

Një firmë auditimi me përvojë mbi pesë vjet mund të drejtojë deri në katër kandidatë kur ka të paktën dy partnerë angazhimi (EKR) me kushtin që njëri prej partnerëve të angazhimit të ketë më shumë se pesë vjetë në profesion.\*\*\*\*

Në rastet kur formimi i kandidatit nuk gjykohet i mjaftueshëm, Komiteti i edukimit të kandidatëve ka të drejtën t'i kërkojë Këshillit Drejtues zgjatjen e shtazhit për kandidatin në fjalë edhe për një apo më shumë vite të tjerë.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të regjistruar siguron që stazhi të kryhet pranë personave që japin garanci të mjaftueshme për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve.

Stazhi kryhet në Shqipëri. Këshilli Drejtues mund të autorizojë kryerjen e stazhit në një shtet të huaj me kusht që të jetë gjetur një drejtues stazhi dhe koha e qëndrimit jashtë të mos jetë më shumë se një e treta e kohëzgjatjes gjithsej të stazhit.

Për t'u pranuar në stazhin profesional kandidati duhet të plotësojë këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- b) të mos jetë dënuar penalisht ose me dënim plotësues, të natyrës që vë në dyshim ndershmërinë e tij;
- c) c'fuqizohet
- d) të ketë fituar një diplomë të shkollës së lartë, niveli i të cilës të jetë i barasvlershëm, të paktën me diplomën universitare të nivelit të dytë "Master" ose diplomat e barasvlershme me to, për çdonjërin nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomiks apo të barasvlershme me to.

Në zbatim të pikës (d) të paragrafit të mësipërm, Këshilli Drejtues, vlerëson pajtueshmërinë e edukimit universitar të kandidatëve me kërkesat e vendosura në programin e shpallur nga Këshilli Drejtues dhe ju kërkon kandidatëve të marrin masa që brenda periudhës së stazhit të shlyejnë detyrimet e paplotësuara, pranë Institucioneve të arsimit të lartë ose të institucioneve të tjera të njohura.

Instituti mund të kryejë vetë përgatitjet dhe të organizojë testimet për disa disiplina, ku numri i kandidatëve është i konsiderueshëm.

Hyrja në provimin e aftësisë profesionale në cdo rast do të bëhet vetëm pasi të plotësohen kërkesat e parashikuara në programin e edukimit të shpallur nga Këshilli Drejtues.

### **3. Përrjashtimi i kandidatëve nga detyrimi për kryerjen e stazhit profesional**

Përrjashtohen nga detyrimi për stazhin profesional individët që, për pesëmbëdhjetë vjet, kanë qënë të angazhuar në veprimtari profesionale, të cilat u kanë dhënë mundësi të fitojnë përvojën e mjaftueshme në fushën e financës, të legjislacionit të kontabilitetit dhe të auditimit, nga të cilat të paktën për pesë vitet e fundit rresht kanë qënë të angazhuar në mënyrë të konsiderueshme, në çështjet e kontabilitetit dhe të auditimit, përkatësisht për një periudhë tre dhe dy vjecare. Këta individë i nështrohen të njëjtit proces certifikimi, të cilit i nështrohen edhe kandidatët. Propozimi për çdo rast përrjashtimi nga detyrimi i kryerjes së stazhit profesional bëhet me vendim të Këshillit Drejtues, i cili njofton Bordin e Mbikëqyrjes Publike. Kopje e vendimit i dërgohet Autoritetit të Certifikimit.

Përrjashtohen nga detyrimi për kryerjen e stazhit profesional shtetasit shqiptarë, të cilët kanë fituar titullin CPA apo ACCA në një shtet tjetër dhe që janë regjistruar si anëtarë të një organizimi profesional të ekspertëve kontabël të regjistruar në atë shtet ose në një shtet tjetër.

Për të fituar të drejtën e përjashtimit nga kryerja e stazhit profesional, duhet të plotësohen kriteret e mëposhtëme:

Individi që aplikon për të fituar përjashtimin nga kryerja e stazhit profesional duhet të provojë se ka përfunduar studimet e larta dhe është i pajisur me një diplomë të fushës së ekonomisë, dhe ka qënë i angazhuar në veprimtari profesionale, të cilat i kanë mundësuar të fitojë përvojën e duhur në kontabilitet, auditim dhe legjislacion, për një periudhë prej 15 vjetësh.

### **3.1 Do të konsiderohet veprimtari profesionale e përshtatshme për të plotësuar kriterin e angazhimit për një periudhë 15 vjecare:**

- a) Angazhimi përmes punësimit në entitetet e biznesit apo shtetërore në pozicionet që fillojnë nga:
  - Specialistit në departamentin (drejtorinë ose njësinë) e strukturës së entitetit përgjegjëse për financë kontabilitetin, analizën financiare dhe auditimin e brendshëm;
  - Drejtues i departamentit (drejtorisë/ njësisë) strukturore të entitetit;
- b) Angazhimi në kryerjen e shërbimeve profesionale me bazë shërbimet e kontabilitetit nga pozitat e një profesionisti të Lirë, si për shembull, kontablist i miratuar.

### **3.2 Kriteri i përcaktuar në ligj, për angazhimin për pesë vitet e fundit rresht në mënyrë të konsiderueshme në çështje të kontabilitetit dhe auditimit përkatësisht për një periudhë tre dhe dy vjecare, do të konsiderohet i plotësuar në rastet:\***

#### **3.2.1 Angazhimi në mënyrë të konsiderueshme për tre vite në pesë vitet e fundit në çështjet e kontabilitetit do të vlerësohet që plotëson kriterin e mësipërm në rast se kandidati ka qënë i punësuar jo më pak se 2/3 e periudhës trevjecare në çështje të kontabilitetit dhe pjesa tjetër e pesë viteve të fundit në çështje të auditimit.\*** Veprimtari profesionale të angazhimit në kontabilitet do të konsiderohen veprimtaritë si mëposhtë:\*

- a) Angazhimet e parashikuara në pikën 3.1, kur objekti i punës ka qënë:
  - i. përgatitja e pasqyrave financiare për qëllime të përgjithëshme.
  - ii. Raportimi, analiza apo kontrolli i pasqyrave financiare
- b) Angazhimet si pedagog në shkollën e mesme ose të lartë, përfshirë angazhimet si lektor për standardet kombëtare e ndërkombëtare të kontabilitetit, si edhe,



**3.2.2** Angazhimi në mënyrë të konsiderueshme për dy vite në pesë vitet e fundit në çështjet e auditimit do të vlerësohet që plotëson kriterin e mësipërm në rast se kandidati ka qenë i punësuar jo më pak se 2/3 e periudhës dyvjeçare në çështje të auditimit dhe pjesa tjetër e pesë viteve të fundit në çështje të kontabilitetit.

Veprimtari profesionale të angazhimit në auditim do të konsiderohen veprimtaritë si mëposhtë:\*

- a) Angazhimet në auditim pranë një shoqërie (firme) auditimi të regjistruar në listën e publikueshme të ekspertëve kontabël të regjistruar (regjistrin publik).  
Nuk konsiderohen angazhimet e individit në firmën e auditimit në pozicione të tilla si administrimi, shërbimet e sekretarisë, shërbimet tatimore, ato të vlerësimit, e të tjera të ngjashme, të cilat nuk vlerësohen se kanë lidhje me auditimin ligjor.
- b) Angazhimet si auditues i brendshëm i entiteteve, të cilat për raportimin financiar zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

### **3.3 Dokumentacioni që duhet të paraqitet për të përfituar përjashtimin nga kryerja e stazhit profesional**

Individët që aplikojnë për të përfituar përjashtimin nga detyrimi i kryerjes së stazhit profesional duhet të paraqesin në IEKA dokumentet e mëposhtëme:

- a) Kërkesë me shkrim, ku të argumentohet se plotësohen kërkesat e parashikuara nga ligji;
- b) Kopjen e diplomës së shkollës së lartë dhe listën e notave të noterizuar;
- c) Vërtetim mbi gjëndjen gjyqësore;
- d) Kopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës për jashtë shtetit, të noterizuara;
- e) Curriculum vitae të aktualizuar që fillon nga periudha më e fundit dhe shkon në periudhën më të hershme;
- f) Kopjen e librezës së punës të noterizuar, shoqëruar me vërtetime në formën e referencave zyrtare të lëshuara nga punëdhënësit përkatës, ku jepen detaje mbi llojin e punëve të kryera;
- g) Kopje të certifikuara të kualifikimeve të ndjekura apo të veprimtarive përkatëse profesionale ku individi është përfshirë;
- h) Në lidhje me 5 vjeçarin e fundit, kandidati duhet të paraqesë vërtetime që specifikojnë angazhimin e tij në veprimtaritë e auditimit dhe të kontabilitetit, përfshirë një listë me angazhimet ku ka marrë pjesë, përshkrime të proceseve të kontabilitetit apo të auditimit ku është angazhuar, etj. të ngjashme.

- i) Cdo dokument tjetër që gjykohet nga komiteti se provon përmbushjen e kërkesave të ligjit.

### **3.4 Personat\*\*\* që kanë fituar titullin CPA apo ACCA në një shtet tjetër,**

Shtetasit shqiptarë që kanë fituar titullin CPA apo ACCA në një shtet tjetër, kur plotësojnë kushtin e anëtarësisë në një organizëm profesional të ekspertëve kontabël të regjistruar në një shtet tjetër, përpara se të regjistrohen në regjistrin publik të EKR-ve, duhet të kalojnë me sukses provimet në dy disiplinat e mëposhtëme:

- (a) e drejtë civile, e drejtë penale, legjislacioni tregtar dhe e drejtë e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë auditimit ligjor të pasqyrave financiare; dhe
- (b) legjislacioni fiskal në Republikën e Shqipërisë.

#### **3.4.1 Për t'u regjistruar për dhënien e provimeve këta shtetas duhet të paraqesin në Institut dokumentet e mëposhtëme:**

- (a) Kërkesë me shkrim, ku të parashtrohet kërkesa për përjashtim nga kryerja e stazhit profesional;
- (b) Kopjen e diplomës së shkollës së lartë dhe listën e notave të noterizuara;
- (c) Kopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës për jashtë shtetit të noterizuara;
- (d) Curriculum vitae të aktualizuar që fillon nga periudha më e fundit dhe shkon në periudhën më të hershme;
- (e) Kopje të certifikuar (me apostille) të titullit ACCA ose CPA të marrë një shtet tjetër, të shoqëruar me programin aftësisë profesionale për të cilin është testuar;
- (f) Vërtetim të certifikuar (me apostille) që tregon për gjëndjen e anëtarësisë në organizmin e huaj të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- (g) Cdo dokument tjetër që gjykohet nga Komiteti se provon përmbushjen e kërkesave të ligjit.

### **3.5 Shtetasit e huaj që janë auditues dhe kërkojnë të regjistrohen në regjistrin publik të ekspertëve kontabël të regjistruar, duhet ti drejtojnë një kërkesë me shkrim Këshillit Drejtues i cili në bazë të pikës 3 të nenit 22 të Ligjit 10091 bën vlerësimin e pajtueshmërisë së programit të përgatitjes së ekspertit kontabël të huaj me programin e ekspertit kontabël vendas.\*\*\***

**Nëse Këshilli Drejtues vendos për pajtueshmërinë e programit atëherë kandidati për t'u regjistruar për dhënien e provimeve duhet të paraqesë në Institut**

**dokumentat si në pikën 3.4.1 më sipër, dhe të kalojë me sukses provimet në dy disiplinat e mëposhtëme:\*\*\***

- (a) e drejtë civile, e drejtë penale, legjislacioni tregtar dhe e drejtë e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë auditimit ligjor të pasqyrave financiare; dhe
- (b) legjislacioni fiskal në Republikën e Shqipërisë.

### **3.6 Shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikimeve.**

**3.6.1** Aplikimet e të interesuarve në zbatim të pikës **3.3, 3.4.1** dhe **3.5** i shqyrton Komiteti i Edukimit të Kandidatëve për EKR të IEKAs.

**3.6.2** Drejtori Ekzekutiv i IEKA-s do të jetë anëtar i Komitetit të Edukimit në rastet e shqyrtimit të aplikimeve sipas pikes 3.6.1

Komiteti i Edukimit, gjatë shqyrtimit të kërkesave për aplikimet sipas pikës 3.3, sipas rastit, duhet të kërkoj informacione shtesë për tu bindur për vërtetësinë e dokumentacionit të sjellë.

Në përfundim të shqyrtimit, vlerëson pajtueshmërinë e tyre me kriteret e dhëna në pikën 3.1 dhe 3.2 të rregullores së edukimit dhe i paraqet Këshillit Drejtues një relacion ku shprehet opinioni në lidhje me kërkesën e bërë.

Komiteti i Edukimit shqyrton edhe kërkesat sëbashku me dokumentacionin e paraqitur nga shtetasit shqiptarë apo që kanë fituar titullin CPA apo ACCA në një shtet tjetër, bën verifikimin e saktësisë, vlerësimin e tyre si edhe kushtin e anëtarësisë në një organizatë dhe i raporton me shkrim këshillit Drejtues.

Komiteti i Edukimit shqyrton edhe kërkesat sëbashku me dokumentacionin e paraqitur nga shtetasit e huaj, bën verifikimin e saktësisë, vlerësimin e tyre dhe i raporton me shkrim këshillit drejtues.

## **4. Procedurat e hyrjes në stazh**

Kërkesat për hyrje në stazh bëhen në periudhën **1 Nentor** deri **15 Nentor** te cdo viti Ato dërgohen në rrugë postare ose depozitohen dorazi në Institut. Kërkesa për hyrje në stazh do të jetë e shoqëruar nga dokumentet që justifikojnë përmbushjen e kërkesave të nenit 16 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009, si dhe të ketë të bashkangjitur marrëveshjen e stazhit të nënshkruar nga të dy palët. Këshilli drejtues përcakton dhe publikon llojet e dokumentave që do të paraqiten si dhe modelin tip të marrëveshjes/ve të stazhit.

Kërkesat për hyrje në stazh shqyrtohen nga Komiteti i Edukimit të kandidatëve gjatë muajit **Dhjetor** të cdo viti, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga secili kandidat. Komiteti i Edukimit i paraqet për miratim Këshillit Drejtues brenda datës **15 Dhjetor** listën e

kandidatëve që propozohen për t'u pranuar në stazh si edhe listën e të refuzuarve me argumentet përkatëse.\*

Këshilli Drejtues merr vendim brenda muajit dhjetor të çdo viti. Lista e kandidatëve të pranuar në stazh publikohet në faqen e internetit të IEKA-s. Kandidatëve të cilëve ju refuzohet nga Këshilli i Drejtimit kërkesa për tu pranuar në stazh ju kthehet përgjigje me shkrim duke i dhënë edhe arsyet e refuzimit.ii\*\*

Kandidatët e pranuar detyrohen të paguajnë një kuotë profesionale, që miratohet çdo vit nga Këshilli drejtues. Kjo kuotë është e pa kthyeshme.\*

## **5. Marrëveshja e Stazhit**

Përpara se të fillojë stazhin, kandidati duhet të nënshkruajë një marrëveshje me udhëheqësin e tij.

Marrëveshja e stazhit hartohet në tre kopje dhe i bashkëlidhet kërkesës për hyrje në stazh. Pasi miratohet nga Komiteti i Edukimit një kopje i kthehet drejtuesit të stazhit dhe një kopje i jepet kandidatit. Kopja e tretë, bashkë me kërkesën dhe dokumentet e tjerë për pranimin në stazh ruhen në selinë e Institutit.

Në qoftëse marrëveshja është nënshkruar në emër të një shoqërie ekspertësh, kjo e fundit duhet të ketë caktuar një ekspert kontabël, përgjegjës për drejtimin e stazhit.

Marrëveshja e stazhit përmban:

- Detyrat e palëve të përcaktuara në përshtatje me kërkesat e rregullave për organizmin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar, në këtë rregullore dhe udhëzimet e dhëna nga Instituti.
- Detyrat e drejtuesit të stazhit, i cili siguron formimin profesional të kandidatit përmes përfshirjes së këtij të fundit në veprimtaritë e auditimit dhe të rishikimit, të cilat bëjnë të mundur fitimin e përvojës profesionale të nevojshme.
- Detyrat e kandidatit, vecanërisht ato për respektimin e ligjshmërisë, moscënimin e interesave të drejtuesit të stazhit gjatë kryerjes së stazhit, dhe për përkushtimin në punë e mbajtjen e lidhjeve me drejtuesin.

Marrëveshja e stazhit mund të përfshijë edhe një periudhë prove e cila mund të jetë nga 3 muaj deri 6 muaj. Gjatë kësaj periudhe të dy palët mund ta prishin marrëveshjen e stazhit duke paralajmëruar për këtë një muaj para datës së prishjes së marrëveshjes. Pala që paralajmëron prishjen e marrëveshjes njofton paraprakisht komitetin e edukimit të kandidatëve. Pas mbarimit të periudhës së provës marrëveshja e stazhit mund të zgjidhet me pëlqimin e të dy palëve ose për një arsye të ligjshme e cilësuar e tillë nga Komiteti i edukimit të kandidatëve.

## 6. Zhvillimi i Stazhit

- a) Fillimi i stazhit profesional përkon me fillimin e vitit kalendarik. Kandidatët e pranuar në stazh i nënshtrohen një testimi i cili shërben për të testuar njohuritë e formimit të përgjithshëm, njohuritë bazë në fushën e kontabilitetit e financës dhe aftësitë e komunikimit me shkrim dhe nëse gjykohet edhe me gojë. Ky testim organizohet brenda muajve janar - shkurt të vitit të parë të stazhit. Testimi organizohet vetëm njëherë. Mospjesëmarrja në testim është automatikisht skualifikuese. Testimi është eliminues. Fitues shpallet kandidati që fiton të paktën 40 pikë. Kandidati jo fitues nuk vijon stazhin. Ai mund ta rifilloj përsëri stazhin në vitin e ardhshëm.\*\*
- b) Gjatë kryerjes së stazhit profesional kandidatët duhet të përmbushin detyrimet e stazhit dhe të punës dhe të bëjnë përpjekje e të thellojnë njohuritë profesionale, të jenë të bindur e të denjë për profesionin dhe t'i nënshtrohen çdo kontrolli të veprimtarisë së tyre nga ana Institutit.
- c) Stazhi përfshin të paktën 600 orë pune në vit për kandidatet me afat pesë vjeçar dhe ata me kontratë shërbimi\* dhe 800 orë për kandidatët me afat tre vjeçar. Orët e punës në zbatim të nenit 15, pika 2 të Ligjit 10091 (te ndryshuar)\*\*\* të kryhen pranë dhe për llogari të drejtuesit të stazhit, sipas një kalendari që hartohet çdo vit. Orët e punës të EKR në auditimin ligjor të pasqyrave financiare të llogariten me koeficientin 1.5 për efekt të llogaritjes së orëve të auditimit të stazhierëve. Nëse një EKR ka 400 orë pune në auditimin ligjor, nga konvertimi me koeficientin 1.5 (600 orë) rezulton se mund të ndjekë një stazhier me kontratë 5-vjecare. \*\*\*\*\*
- d) Këshilli Drejtues mund të autorizojë që orët e punës të stazhit të kryhen pranë dhe për llogari të më shumë se një eksperti apo shoqëri ekspertësh kontabël, por ky numër nuk mund të jetë më shumë se tre, përfshirë edhe drejtuesin. Stazhieri duhet të bëjë të paktën 70% të orëve të punës tek drejtuesi i stazhit\*\*\*. Një pjesë e orëve të stazhit, sipas vlerësimit të drejtuesit të stazhit dhe miratimit të komitetit të edukimit, mund të kryhet edhe pranë punëdhënësve të tjerë por në poste pune që janë të natyrës kontabël dhe financiare dhe që i shërbejnë formimit profesional të kandidatit.
- e) Në çdo rast drejtuesi i stazhit dhe i kandidatit do të jetë vetëm eksperti kontabël i regjistruar që ka marrë përsipër këtë rol.
- f) Kandidati duhet të përmbushë me kujdes misionet e punëve që i ngarkohen nga drejtuesi i stazhit dhe të ndjekë udhëzimet e dhëna prej tij.
- g) Në çdo rast të:
- ndryshimit të drejtuesit të stazhit nga kandidati apo
  - largimit të kandidatit nga udhëheqësi i stazhit

secila palë duhet ti dërgojë një kërkesë me arsyetimet përkatëse Komitetit të Edukimit të kandidatëve.\*

- h) Stazhieri duhet të respektojë dispozitat ligjore dhe rregullat që lidhen me punën, mungesat në punë dhe pushimet sipas percaktimeve në Kodin e Punës të RSH.
- i) Për stazhierët që nuk respektojnë rregulloren e Edukimit dhe kualifikimit profesional mund të merren masa disiplinore deri në përjashtimin nga kryerja e stazhit. Edhe për udhëheqësit e stazhit të cilët nuk respektojnë kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore në lidhje me marrëdhënien e tyre me stazhierët merren masa disiplinore. Në të dyja rastet me sipër, Këshilli i Drejtimit vendos për masën disiplinore.\*
- j) Kandidati mban një ditë të stazhit në të cilin evidenton punët që ka kryer ose punët në të cilat ka marrë pjesë, duke shënuar emërtimin dhe formën juridike të sipërmarrjes, natyrën e veprimtarisë së saj, karakterin e misionit dhe kohën e punës të realizuar nga kandidati në kryerjen e misionit, e të tjera të dhëna të nevojshme. Ditari mbahet duke ruajtur fshehtësinë (sekretin) profesionale.
- k) Stazhierët me kontratë 5 – vjecare mund ti drejtojnë kërkesë Komitetit të Edukimit kur ata nuk kanë marrë pjesë në trajnimin/testimin dhe kërkojnë njohjen e vitit të stazhit me të drejtë ndjekjen e tyre vitin tjetër të stazhit. Trajnimet duhet të frekuentohen në radhë kronologjike.\*\*<sup>iii</sup>
- l) Gjatë periudhës së stazhit, kandidati është i detyruar të marrë pjesë në seminarët kualifikuese të organizuara nga Instituti dhe t'i nënshtrohet një testimi për njohuritë e marra, i cili është i detyrueshëm. Nuk mund të hyjë në testim ai kandidat i cili nuk ka ndjekur trajnimin për më shumë se 20% të orëve të tij, qofshin këto edhe të arsyeshme. Për kandidatët që nuk kanë ndjekur trajnimin deri në 20% të orëve, hyrja në testim do të gjykohet rast pas rasti nga Komiteti i Edukimit.\*\* Testimi kryhet vecas për cdo seminar apo kurs kualifikimi të zhvilluar. Kriteret e hyrjes, programi, organizimi dhe procedurat e testimit të kandidatëve që aplikojnë për të hyrë në stazh do të detajohen në një rregullore të vecantë, e cila do miratohet nga Këshilli i Drejtimit.\*
- m) Vlerësimi bëhet me pikë deri në 100. Kur kandidati siguron më pak se 40 pikë, ai detyrohet të përsëritë testimin. Shpenzimet për ritestim përballohen nga kandidatët përsëritës.
- n) Kandidatët (Stazhierët) kanë të drejtë të përsëritin testimin e një viti stazhi vetëm një herë në sezon. Në rast se nuk rezultojnë fitues ata detyrohen të përsëritin testimin vitin tjetër. Nëse edhe vitin tjetër nuk rezultojnë fitues, ata nuk mund të vazhdojnë më tej stazhin.\*
- o) Në periudhën shtator – nëntor, kandidatët që përfundojnë stazhin duhet të depozitojnë e mbrojnë një punim profesional që përfshin trajtime teorike e praktike në çështje me interes për profesionin që përcaktohen nga Komiteti i Edukimit. Kandidatët që kanë marrëveshje stazhi të konvertuar nga 5 vjet në 3 vjet nëse e përfundojnë stazhin deri më 30 mars, duhet ta depozitojnë dhe mbrojnë këtë punim në periudhën tetor–nëntor të vitit paraardhës. Nëse e përfundojnë stazhin mbas kësaj date atëherë ata e depozitojnë dhe mbrojnë këtë punim në periudhën tetor-nëntor të vitit në vijim.\*\*

- p) Kandidati, gjatë kryerjes së stazhit është i detyruar të zbatojë kërkesat e legjislacionit në fuqi, vendimet e Asamblesë dhe të Këshillit Drejtues të Institutit dhe të Komitetit të Edukimit. Ai respekton rregullat dhe kërkesat e parashikuara në Kodin e Etikës për Ekspertët Kontabël të Regjistruar, dhe në rast të shkeljes së tyre, mund të ndëshkohet deri në përjashtim nga stazhi.
- q) Drejtuesi i stazhit, duke qenë përgjegjësi kryesor për formimin e kandidatit, duhet t'i mundësojë kandidatit kryerjen e stazhit në kushte optimale dhe mund t'i ngarkojë edhe kryerjen e punëve profesionale nën udhëzimin dhe mbikeqyrjen e tij.
- r) Drejtuesi i stazhit kontrollon mbajtjen e ditarit nga kandidati dhe shënon atje të gjitha rezultatet sinjifikative të vëzhgimeve të tij. Ai njihet rregullisht me raportimet e kandidatit. Drejtuesi i stazhit dhe kandidati nënshkruajnë ditarin e stazhit pasi kanë diskutuar vërejtjet e bëra nga drejtuesi.
- s) Kandidatët janë të detyruar që të regjistrojnë të gjitha punët e kryera në një ditar stazhi, i cili mbahet në dy kopje dhe dorëzohet vetëm një herë në vit, jo më vonë se data 10 janar\*\*\*. Njëra nga kopjet dorëzohet në Institut së bashku me raportin dhe vlerësimin e bërë nga eksperti kontabël i regjistruar, i cili është drejtuesi i stazhit për kandidatin. Në rast të mosdorëzimit brenda afatit, Komiteti i Edukimit jep vërejtje dhe vendos një afat të dytë paralajmërues për depozitimin, jo më vonë se data 25 Janar. Nëse shkelet edhe afati i dytë, pavarësisht arsyes stazhieri përsërit vitin e stazhit dhe mund ta dorëzojë ditarin vetëm vitin e ardhshëm.\*\*\*
- t) Eksperti Kontabël i Regjistruar apo shoqëria audituese, që ka nënshkruar kontratë me kandidatin, i raporton Institutit vlerësimin e tij çdo gjashtë muaj për ecurinë e këtij të fundit dhe për përfundimin e stazhit profesional. Raportimi bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës.
- u) Komiteti i Edukimit analizon raportet e paraqitura dhe i raporton Këshillit Drejtues në përputhje me afatet e përcaktuara në Kapitullin 1, pika 4 e kësaj rregulloreje "Raportimi".\*
- v) Me një kërkesë të arsyetuar të kandidatit ose të drejtuesit të stazhit, Komiteti i Edukimit mund të autorizojë një ndërprerje të përkohëshme të stazhit duke përcaktuar edhe kohën e kësaj ndërprerjeje. Ndërprerja ose ndërprerjet nuk mund të jenë në total më shumë se dy vjet. Koha e ndërprerjes zgjat afatin e qëndrimit në stazh. Kur stazhieri mbetet pa drejtues ndërprerjet lejohen max 1 muaj kur është me kohë të plotë ose kontabël i miratuar dhe max 2 muaj kur është me kohë të pjesshme.\*\*\*
- w) Stazhi merr fund
- me lëshimin e certifikatës së mbarimit të stazhit,
  - kur kandidati tërhiqet nga stazhi,
  - kur kandidati përjashtohet nga stazhi,
  - Kur kandidati nuk kalon testin e të njëjtit vit stazhi për dy vjet rresht,
  - Kur ndërprerja ose ndërprerjet janë në total më shumë se dy vjet.

### Kapitulli 3

#### Zhvillimi profesional i vijueshëm i anëtarëve

- a) Për të garantuar mbrojtjen e interesit publik, cdo anëtar i Institutit duhet të demonstrojë në cdo rast aftësi profesionale, kompetencë dhe qëndrime e vlera etike të larta. Për këtë qëllim anëtarët e Institutit duhet të plotësojnë detyrimin e kualifikimit profesional të vijueshëm në pajtim me programet e shpallura nga Këshilli Drejtues, përmes pjesëmarrjes në seminarët e kualifikimit të vijueshëm.
- b) Kohëzgjatja e seminareve të kualifikimit të vijueshëm të detyrueshëm, e cila nuk mund të jetë më pak se 40 orë në vit, propozohet nga Komiteti i Kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve dhe miratohet cdo vit nga Këshilli Drejtues.
- c) Programet e zhvillimit të vijueshëm profesional, të cilat hartohen nga Komiteti i Kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve miratohen nga Këshilli Drejtues cdo vit brenda datës 28 Shkurt. Këto programe së bashku me kalendarin kohor të zhvillimit të kualifikimeve që organizohen nga vetë instituti, publikohen në faqen e internetit të IEKAs brenda muajit Mars dhe ju njoftohen të gjithë anëtarëve.
- d) Në përcaktimin e programit të zhvillimit profesional të vijueshëm mbahen parasysh kërkesat e anëtarëve të veçantë apo grupeve të anëtarëve, si edhe zhvillimet kombëtare e ndërkombëtare të cilat ndikojnë në profesionin e ekspertit kontabël të regjistruar.
- e) Përveç organizimit nga Instituti, kurset për kualifikimin e vijueshëm profesional mund të organizohen edhe nga institucione të arsimit të lartë; qendra të tjera të kualifikimit profesional, të cilat kanë mjediset dhe personelin e duhur për garantimin e një kualifikimi cilësor, në përputhje me programet e miratuara për kualifikimin e vazhdueshëm profesional si edhe, nga shoqëritë e auditimit, të cilat kanë kapacitetet e duhura për të organizuar kualifikimin për të punësuarit e tyre.
- f) Të tretët që dëshirojnë të përfshihen në realizimin e programeve të zhvillimit profesional të ekspertëve kontabël të regjistruar, janë të detyruar të venë në dijeni Bordin e Mbikëqyrjes Publike.
- g) Ata kooperojnë e koordinojnë me Këshillin Drejtues të Institutit, në lidhje me mundësitë që kanë apo për informacione të mëtejshme që ata mund të kërkojnë, për të realizuar një pjesë apo të gjitha programet e edukimit të shpallura nga instituti.
- h) Mospërmbushja, nga ekspertët kontabël të regjistruar, e kërkesave të zhvillimit profesional të vijueshëm të detyrueshëm, dështimet në testimin e njohurive të marra nga kualifikimi i vijueshëm, apo depozitimi i dokumenteve të pavërteta për kryerjen e kurseve të kualifikimit të vazhdueshëm nga të tretët, mund të cojnë në pezullimin e ushtrimit të profesionit nga Bordi i Mbikëqyrjes publike dhe çregjistrimin e ekspertëve kontabël nga regjistri publik.



- i) Në përfundim të çdo kursi kualifikimi të vijueshëm, eksperti kontabël pajiset me vërtetimin e plotësimit të detyrimit, si dhe me vlerësimin përkatës kur kjo është e përshtatshme. Vërtetimi depozitohet në Institut 30 ditë pas përfundimit të trajnimit
- j) Zhvillimi i vijueshem profesional sugjerohet të kryhet edhe nga ekspertët kontabël të cilët nuk e ushtrojnë profesionin. Moskryerja e zhvillimit të vijueshëm profesional nga ekspertët kontabël që nuk e ushtrojnë profesionin, kërkon ritestimin e njohurive të tyre përpara se ata të kërkojnë të përfshihen në regjistrin publik.
- k) Ekspertët kontabël të cilët nuk e ushtrojnë profesionin pajisen me vërtetim në cdo rast që ndjekin zhvillimin e vijueshëm profesional.
- l) Ekspertët kontabël të regjistruar duhet të regjistrohen për kryerjen e kurseve të kualifikimit, kur këto realizohen nga Instituti jo më vonë se dy javë para datës së fillimit të programit, ndërsa në rastet kur ata vendosin ta kryejnë kualifikimin tek institucionet e tjera të njohura, ata janë të detyruar të njoftojnë me shkrim Institutin jo më vonë se dy javë para fillimit të kursit duke dhënë detaje të mjaftueshme për Institucionin, lektorët që do të zhvillojnë seminarët, vendin dhe kalendarin e zhvillimit të kurseve.
- m) Kostot e zhvillimit të vijueshëm profesional përballohen nga ekspertët kontabël të regjistruar.

## **Kapitulli 4**

### **Hyrja në fuqi**

Autorizohet Këshilli Drejtues i Institutit të bëjë plotësime e ndryshime në këtë Rregullore, të cilat i paraqiten për ratifikim asamblesë së përgjithshme të anëtarëve në mbledhjen e ardhëshme. Plotësimet dhe ndryshimet bëhen të zbatueshme që nga data e shpalljes së tyre nga Këshilli Drejtues.

Këshilli Drejtues autorizohet të procedojë me ngritjen e Komitetit të Edukimit të Kandidatëve dhe me Komitetin e Kualifikimit të Anëtarëve.

Kjo rregullore, u miratua nga Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve me vendiminn Nr 65 datë, 19.06.2009.

Rregullorja është plotësuar në kapitullin e dytë (pika 3) me vendimin e Këshillit Drejtues Nr.1 datë 03.02.2010<sup>iv</sup>

<sup>i</sup>\* *Ndryshuar me vendimin e Asamblese Nr.82 dt. 29.06.2011*

<sup>ii</sup>\*\* *Ndryshuar me vendimin e Asamblese Nr.84 dt. 22.12.2011*

<sup>iii</sup>\*\*\* *Ndryshuar me vendimin e Asamblese Nr.90 dt. 28.06.2012*

<sup>iv</sup>\*\*\*\* *Ndryshuar me vendimin e Asamblese nr.99 date 27.06.2013*

<sup>v</sup>\*\*\*\*\* *Ndryshuar me vendimin e Asamblese nr.106 date 28.06.2014*

<sup>vi</sup>\*\*\*\*\* *Ndryshuar me vendimin e Asamblese nr. 128 date 29.06.2017*